


Aplikimi Online në raundin e dytë Formulari A3  
Viti Akademik 2015-2016

Për të kryer aplikimin online duhet të shkoni tek linku: <http://matura.akp.gov.al>

Identifikimi i kryhet si më poshtë:

Te faqja e hapur do të keni pamjen e mëposhtme:



Këtu duhet të klikoni te butoni : **“Apliko”** dhe do t’ju shfaqet pamja e mëposhtme:

Te fushat e shfaqura duhet të plotësohen të dhënat e kërkuara duke patur kujdes. Në fushën **“Karta e Identitetit”** duhet të vendoset **numri personal** (kliko mbi fjalën shembull dhe do të shfaqet një kartë identiteti ilustruese. Numri personal i kartës, i kornizuar si më poshtë, gjëndet në pjesën e poshtme në të djathtë të saj).

Mozilla Firefox

ry Bookmarks Tools Help

bz/aplikimet/StudentidentificationA3.aspx

Search the web (Babylon)

**MATURA SHITËTËRORE**  
Agjensia Kombëtare e Provimeve

REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT

ID e Maturantit

Emri

Atësia

Mbiemri

Karte Identiteti  
- Shembull

Email i Maturantit

Identifikohu

LETËRNOFTIM ID REPUBLIKA E SHQIPËRIE REPUBLIC OF ALBANIA

mbiemri/surname: Haxhi  
 emri/given name: Emri  
 shprehja/nationality: Shqiptare/Albanian  
 vendndërsa/place of birth: [redacted]  
 data lindja/date of birth: [redacted]  
 data e keti/limit/date of issue: -03-2009  
 autoriteti/issuing authority: MB  
 nr. letërnjoftimit/card no.: [redacted]  
 gjinia/sex: F  
 data e skadimit/date of expiry: -03-2019  
 nr. personi/persons no.: [redacted]

Pasi të keni plotësuar fushat e mësipërme, duhet bërë kujdes që informacioni të jetë i saktë sepse përdoret për verifikime të mëvonshme. Pas kësaj klikoni te butoni: **“Identifikohu”**. Nëse të dhënat tuaja nuk janë të sakta do të shfaqet mesazhi i mëposhtëm:




Kjo do të thotë se për të bërë aplikimin online ju duhet të paraqiteni detyrimisht pranë ambjentit që ka caktuar Drejtoria/Zyra Arsimore e rrethit tuaj me dokumentin tuaj personal të identifikimit.

Nëse të dhënat tuaja janë të sakta do të vazhdoni procedurat e aplikimit online sipas hapave të mëposhtme. Sipas rastit shfaqen në ekran dritaret e mëposhtme:

### Rasti i parë

Maturanti është shpallur fitues pas aplikimit me formularin A2, dhe është i pa regjistruar, pra nuk ka dorëzuar dokumentat pranë sekretarisë së fakultetit.

Ky maturant do të lejohet të vazhdojë garën në raundin e dytë me preferencat e përzgjedhura në formularin A2.




**Kujdes:** Nëse klikoni mbi butonin e sipërm “konfirmo pjesmarrjen në garë me A2”, nuk mund të anuloni veprimin më pas.

### Rasti i dytë


Maturanti ka plotësuar Formularin A2 dhe nuk është shpallur fitues pas aplikimit me formularin A2, në asnjërin nga preferencat e përzgjedhura .

Ky maturant do të lejohet të vazhdojë garën në raundin e dytë me preferencat e përzgjedhura në formularin A2.



### Rasti i tretë

Maturanti është shpallur fitues pas aplikimit me formularin A2, jo në preferencën e parë. Në regjistrimin online ka konfirmuar vazhdimin e garës dhe është i regjistruar me dorëzim dokumentash pranë sekretarisë së fakultetit. Ky maturant do të lejohet të vazhdojë garën te raundi i dytë me preferencat e përzgjedhura në formularin A2.




Konfirmo pjesmarrjen ne gare me A2

**Kujdes:** Nëse klikoni mbi butonin e sipërm “Konfirmo pjesmarrjen në garë me A2”, nuk mund të anuloni veprimin më pas. Nëse shpalleni fitues në preference më të lartë se ajo në të cilën jeni regjistruar me dorëzim dokumentash në sekretari në raundin e parë, sistemi ju regjistron automatikisht nga preferenca në të cilën jeni regjistruar në raundin e parë dhe ju do të paraqiteni për tu regjistruar në preferencën ku jeni shpallur fitues në këtë raund(raundi i dytë).

#### Rasti i katërt


Maturanti është shpallur fitues pas aplikimit me formularin A2 në preferencën e parë dhe është rregjistruar në këtë program duke kryer dorëzimin e dokumentave në fakultet.

Ky maturant nuk do të lejohet të vazhdojë garën në raundin e dytë.



## Rasti i pestë

Fitues pas aplikimit me formularin A2, jo në preferencën e parë, i cili në regjistrimin online ka konfirmuar ndërprerjen e garës duke klikuar butonin: “Konfirmoj regjistrimin përfundimtar në preferencën e fituar” dhe ndërkohë është i regjistruar me dorezim dokumentash pranë sekretarisë së fakultetit. Ky maturant nuk do të lejohet të vazhdojë garën në raundin e dytë.



## Rasti i gjashtë

Nuk ka plotësuar formulari A2 në raundin e parë. Kjo kategori maturantësh duhet të paraqiten në shkollat përkatëse me mandat pagesën prej 2'000 lekësh të bërë në një nga zyrat e Postës Shqiptare ose bankave të nivelit të dytë ku do të bëhet plotësimi i notës/pikëve mesatare në sistem.

Pas kësaj procedure ky maturant do të lejohet të vazhdojë garën në raundin e dytë duke plotësuar formularin A3. Atij do t'i shfaqet dritarja e mëposhtme, ku do të përzgjedhë programet e studimit në të cilat do të konkurrojë në të njëjtën mënyrë si tek formulari A2 (Shih paketën informuese për plotësimin e formularit A2 në faqen zyrtare të MAS dhe AKP [www.arsimi.gov.al](http://www.arsimi.gov.al) dhe [www.akp.gov.al](http://www.akp.gov.al)).



Menu

Gjeneralitete të Studentit

Notat e Provimeve

## Formulari A3

<b>Emri</b> FATON	<b>Vendlindja</b> FAJZE, KUKËS	<b>Nota Mesatare</b> 5.03
<b>Atësi</b> NAZIF	<b>Shkolla e Mesme</b> (346) MYSLIM SHIMA, TIRANË QARK	<b>LETËRSI E VJETËR ARISTIKE</b> 4.96
<b>Mbiemri</b> SPAHJU	<b>Profili</b> GJIMNAZI ME KOHË TË SHKURTUAR	<b>MATEMATIKË PEDAGOGJIKE</b> 4.00
<b>Gjinia</b> Mashkull		<b>Gjeografi</b> 5.72
<b>Datelindja</b> 06/09/1991		<b>Qytetari</b> 4.60

Programe Studimi dhe Pikët Minimale nga faza 2 - 2012:

-- Zgjidh --

[+] Përzgjidhe Programin

Ju nuk keni përzgjedhur asnjë program studimi akoma.

Dergoje Formularin

1. Në pjesën e sipërme maturantit i shfaqen të gjitha gjeneralitetet si dhe pikët/nota mesatare e shkollës së mesme si dhe notat e marra gjatë provimeve të Maturës Shtetërore.
2. Poshtë të dhënave personale të maturantit është një Drop Down List e cila i jep mundësinë atij që të përzgjedhë programet e studimit që ofrohen në raundin e dytë nga IALP-të.
3. Pas përzgjedhjes, më poshtë, shfaqen pikët që maturanti grumbullon në këtë program studimi dhe pikët e fituesit të fundit në fazën e dytë të aplikimit me formularin A2. Duke i krahasuar pikët e tij të grumbulluara me këto të fundit, maturanti mund të marrë vendim që ta përzgjedhë ose jo atë program studimi. Për ta përzgjedhur një program studimi ai duhet të klikojë mbi butonin **Përzgjidhe Programin**.
4. Sistemi informatik nuk të lejon që të përzgjidhem më shumë se 10 preferenca, por lejon që të fshihet ndonjëra prej tyre si dhe të rirenditen ato. Nëse duhet të heqim një program studimi mjafton të klikojmë tek butoni "Hiq" ndërsa për t'i rirenditur në kutizat anësore duhet të shtypim renditjen e re të propozuar dhe më pas klikojmë mbi butonin poshtë "Ruaj Renditjen" (Kujdes! Gjatë vendosjes së renditjes së re nuk duhet të kemi përsëritje numrash)

Windows Internet Explorer

tysh.tirana.bz/aplikimet/Protected/DataEntry/A2Form/AppA3.aspx

ites Tools Help

Search Cursor Mania Smiley Central Screensavers MyFunCards

uggested Sites Free Hotmail Web Slice Gallery

KRYESORE MATURA UDHËZIME DHE FORMULARË PROGRAME ORIENTUESE TESTE PËRGATITORE VITET MË PARË

Perdoruesi: 12263000022 | | Ndrysho fjalekalim

Menu

- Gjeneralitete të Studentit
- Notat e Provimeve

## Formulari A3

<b>Emri</b> RODRIK	<b>Vendlindja</b> BERDICË,SHKODËR	<b>Nota Mesatare</b> 5.39
<b>Atësia</b> SALVATOR	<b>Shkolla e Mesme</b> (300) FREDERIK GJONI, SHKODËR	<b>LETËRSI 2012</b> 5.63
<b>Mbiemri</b> PJETRUSHI	<b>Profili</b> GJIMNAZI 2012	<b>MATEMATIKË 2012</b> 6.02
<b>Gjinia</b> Mashkull		<b>Psikologji</b> 5.60
<b>Datelindja</b> 11/03/1993		<b>Qytetari</b> 7.06
		<b>Gjeografi</b> 5.72

**Programe Studimi dhe Piket Minimale nga faza 2 - 2012:**

143 - UNIVERSITETI I ELBASANIT "Aleksandër Xhuvani" - Financë - Kontabilitet

[+] Perzgjidhe Programin

Preferenca	Programi i Studimit	Kodi	Universiteti
1 Hiqe	Inxhinieri Gjeoinformatikë	088	UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
2 Hiqe	Përpunim Druri	067	UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS
3 Hiqe	Gjuhë Italiane	186	UNIVERSITETI I SHKODRËS "Luigj Gurakuqi"
4 Hiqe	Shkenca Kompjuterike	195	UNIVERSITETI I VLORËS "Ismail Qemali"
5 Hiqe	Mësuesi për Arsimin Fillor	161	UNIVERSITETI I GJIROKASTRËS "Eqrem Çabej"

Ruaj Renditjen

Dergoje Formularin

1. Teksojmë edhe njëherë se për suksesin e aplikimit me formularin A3 janë të rëndësishme jo vetëm llojet e programeve të studimi të përzgjedhura por dhe renditja e tyre.
2. Më pas klikoni mbi butonin "Dërgoje Formularin" dhe shfaqet dritarja e mëposhtme që ju jep mundësinë e printimit të formularit A3.

